



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 821 / Prot.

Tiranë, më 31 /08/2016

VENDIM

Nr. 59 , datë 31 / 8 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 821 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me emailin e datës 24.07.2016 ka kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë t'i vihet në dispozicion *kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar*.

Përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, me anë të emailit të datës 27.07.2016 i ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar me arsyetimin se: *Kërkesa nuk mund të plotësohet, mbasi informacioni që ju kërkonit përmban të dhëna personale, publikimi i të cilave shkel të drejtën e privatësisë të punonjësve të stafit të Prokurorisë*.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se autoriteti publik ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 15, pika 1 e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Gjithashtu vlerësohet se informacioni i kërkuar nga Z. është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Informacioni mbi organikën e stafit që punon në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, rolin, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare si dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës një përshkrim të strukturës organizative, funksionin, dhe detyrat e autoritetit publik.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Z. \_\_\_\_\_, Nr. 821 Prot., datë 27.07.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Prokuroria e Përgjithshme/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt *"Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare"*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Prokuroria e Përgjithshme/ Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*kopje e plotë e listës/organikës së stafit që punon në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë duke përfshirë rolin/funksionin e punës, emër, mbiemër, adresën e postës elektronike zyrtare dhe numrin e telefonit për përdorim zyrtar*), brenda datës 7.09.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 31. 8.2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI